Trusti

BULETINI TREMUJOR
NR 50 – VITI XIII – TM2 2020

**FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS**

# TRUSTORJA

## 1) PERFORMANCA

| PERIUDHA | 1 MUAJ | 3 MUAJ | VITI AKTUAL | 3 VJET | 5 VJET | NGA THEMELIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **REZULTATI** | +2.75% | +3.55% | -1.28% | +6.78 | +12.51% | +49.13% |
| **BENÇMARKU*** | -0.47% | -1.03% | -0.57% | +3.84% | +5.51% | +37.45% |

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

## 2) LËVIZJET MUJORE

| ÇMIMI I AKSIONIT | | KTHIMI BRUTO | KTHIMI NETO |
|---|---|---|---|
| PRILL | +2.75% | €53,316,778.39 | €52,618,708.84 |
| MAJ | +0.55% | €11,672,356.27 | €10,938,552.82 |
| QERSHOR | +0.23% | €5,267,440.01 | €4,608,287.97 |
| **TREMUJORI** | **+3.55%** | **€70,256,574.67** | **€68,165,549.63** |

## 3) KONTRIBUIMI

| KONTRIBUTE TË REJA | | LLOGARI TË REJA | LLOGARI AKTIVE |
|---|---|---|---|
| PRILL | €11,781,316.48 | 2,520 | 679,351 |
| MAJ | €15,618,711.09 | 2,969 | 682,318 |
| QERSHOR | €14,849,243.29 | 3,273 | 685,590 |
| **TREMUJORI** | **€42,249,270.86** | **8,762** | **682,420*** |

*Mesatarja e llogarive këtë tremujor

## 4) PENSIONIMET

| PËRFITUES PENSIONI | | SHUMA E TËRHEQUR |
|---|---|---|
| PRILL | 272 | €2,715,192.66 |
| MAJ | 772 | €6,191,850.79 |
| QERSHOR | 838 | €5,814,031.66 |
| **TREMUJORI** | **1,882** | **€14,721,075.11** |

| ARSYET | | |
|---|---|---|
| PENSION MOSHE | RASTE VDEKJESH | TË TJERA |
| 248 | 16 | 8 |
| 698 | 52 | 22 |
| 637 | 120 | 81 |
| **1,583** | **188** | **111** |

# PLASMANET DHE PERFORMANCA

| MENAXHUESI \|\| FONDI \|\| BANKA \|\| BROKERI | EMËRTIMI I FONDIT OSE NUMRI ISIN | PLASMANET FUNDI TM2 | KTHIMI BRUTO NË INVESTIME |
|---|---|---|---|
| Vanguard | Global Stock Index Fund | €20,825,819 | €1,381,129.35 |
| Nordea | 1-Stable Return Fund | €276,188,488 | €5,973,180.48 |
| Nordea | 1-Global Stable Equity Fund | €85,553,295 | €3,703,895.08 |
| BNY Mellon | Global Real Return Fund | €295,296,257 | €18,918,114.56 |
| AXA | Global Inflation Linked B. | €31,296,087 | €1,693,064.60 |
| AXA[2)] | AXA WF Optimal Income I | -- | €704,105.30 |
| Amundi 3M | Amundi 3M - I | €175,763,445 | €(165,706.40) |
| Amundi[2)] | Amundi Rendement Plus | -- | €4,881,344.26 |
| BNP Parvest | Diversified Dynamic | €102,869,191 | €3,806,855.50 |
| Schroders | Global Diversified Grouth | | €3,357,002.10 |
| ERSTE | ETF-IE00BYX8XD24 | €20,376,403 | €5,788,706.48 |
| ERSTE[1)] | ETF-IE00B3F81R35 | -- | €2,714,762.18 |
| ERSTE[1)] | ETF-LU1681039647 | -- | €2,803,255.75 |
| ERSTE | ETF-IE00B86MWN23 | €29,963,458 | €4,906,792.13 |
| ERSTE[1)] | ETF-DE0005933956 | -- | €1,241,446.11 |
| ERSTE[1)] | ETF-IE00B3ZW0K18 | -- | €3,769,698.67 |
| ERSTE | ETF-US46090E1038 | €87,089,321 | €1,934,310.17 |
| Thesari i Kosovës | Obligacione | €392,049,964 | €1,958,722.97 |
| Banka në Kosovë | Depozita me afat | €196,505,839 | €672,888.30 |
| BQK - të gatshme | Të painvestuara | €291,714,931 | €(27,512.54) |
| Të hyra të tjera | | -- | €240,519.62 |
| **GJITHSEJ** | | **€2,005,492,498** | **€70,256,574.67** |

**1)** I gjithë investimi nga ky fond është tërhequr gjatë TM2 2020.

# LAJME

| | |
|---|---|
| **ÇËSHTJA 10%-SHIT, DREJTUESIT E TRUSTIT U TAKUAN PËR KRYEMINISTRIN E VENDIT** | Anëtarë të Bordit Drejtues dhe Menaxhmentit të FKPK-së, kanë zhvilluar më 1 korrik 2020, një takim konsultues me Kryeministrin e vendit, z. Avdullah Hoti. Temë e takimit ishte plani i Qeverisë për t'ju dhënë mundësinë kontribuuesve të tërheqin 10% të bilancit të tyre të kursimeve pensionale nga FKPK-ja. Në takim morën pjesë edhe Ministrja e Financave si dhe Guvernatori dhe Zëvendësguvernatori i BQK-së.<br><br>Kryesuesi i Bordit Drejtues theksoi në takim se ekzistojnë modalitete dhe alternativa të tjera që do të mundësonin arritjen e synimeve të Qeverisë – që është rritja e kërkesës agregate në vend – dhe se këto alternativa do të ishin më efektive, në veçanti nga këndvështrimi i operacionalizimit, respektivisht implementimit në praktikë të propozimit ekzistues. Tutje, Kryesuesi i Bordit Drejtues të FKPK-së elaboroi propozimet që do të mund të kontribuonin në mbështetje të ekonomisë së vendit, në këtë kohë mjaft sfiduese.<br><br>Nga ana tjetër, Kryeministri i vendit, z. Hoti, konfirmoi se mundësia e tërheqjes së 10%-shit është pjesë e planit të punës të Qeverisë dhe ngelet vetëm përgatitja teknike për implementim. Ai po ashtu ka deklaruar se FKPK-ja duhet të shikojë mundësitë për të zgjeruar kapacitetet operuese për ta përballuar zbatimin e këtij plani të tërheqjes. |
| **VENDIMET E BORDIT DREJTUES PËR INVESTIMET MË 25 QERSHOR 2020** | Bordi Drejtues i Trustit, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Investimeve, i ka marrë këto vendime rreth investimeve në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2020 në Prishtinë:<br><br>1) Të likuidohen në tërësi alokimi nga: Amundi Euro Corp IG ETF (në vlerë €60.1m); iShares Euro Corp IG ETF (në vlerë €60.1 mln); AXA Optimal Income (në vlerë €9.6 mln); Amundi Rendement Plus (në vlerë €82.3 mln), dhe Schroder Global Diversified Growth ( në vlerë €41.3 mln).<br><br>2) Të tërhiqen pjesërisht mjete nga: iShares S&P 500 Minimum Volatility ETF (në vlerë prej €31.6 mln) dhe nga iShares MSCI Europe Minimum Volatility ETF (në vlerë prej €22.2m).<br><br>3) Të rritet alokimi në: Vanguard Global Stock Index (në vlerë €54.0 mln); Invesco QQQ Nasdaq ETF (në vlerë €54.7 mln); Nordea Stable Return (në vlerë €50.0 mln); BNY Mellon Real Return (në vlerë €30.0 mln); AXA Global Inflation Linked Bond (në vlerë €120.0 mln). |
| **KUVENDI I MIRATOI TARIFAT MENAXHUESE PËR 2020** | Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka miratuar më 4 qershor 2020 tarifat menaxhuese të ndryshuara për pjesën tjetër të vitit 2020. Tarifat e miratuara, siç janë propozuar nga Bordi Drejtues i FKPK-së, u ulën nga 0.370% në 0.330% për aktivitetet investuese dhe nga 0.069% në 0.065% për aktivitetet operacionale.<br><br>Kujtojmë se FKPK-ja operon me normat më të ulëta të tarifave në rajon dhe më gjerë. Këto tarifa do të hyjnë në fuqi nga data 5 qershor 2020. |

**PUBLIKON:**
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Korrik 2020

**AUTOR:**
Jeton Demi

**ADRESA:**
Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

**E-MAIL & UEB**
info@trusti.org www.trusti.org

TrustiPensional